

Edizioni i 2<sup>të</sup>

TEXTILE

& Leather

Expo / 2019

Nëntor  
01 - 02  
2019



EXPOCTY  
ALBANIA

ufi  
Member



# TEXTILE & Leather

Expo / 2019

N ë n t o r  
0 1 - 0 2  
2 0 1 9



## Objektivi

Edicioni i 2<sup>të</sup> i "Panairit të Tekstilit & Lëkurës 2019" është një nga eventet më të shumëpritura për industrinë e tekstilëve dhe lëkurës, për të gjithë profesionistët që kanë në fokus zhvillimin e sektorit në Shqipëri, rritjen e tyre individuale dhe atë kolektive. Ky panair përfaqëson një pikë-takimi për prodhuesit më të mëdhenj e më të rëndësishëm shqiptarë dhe të huaj. Ky event fokusohet në sfidat më të rëndësishme për të ardhmen e sektorit, duke stimuluar dhe rritur dialogun mes kompanive. Gjithashtu, panairi do të shërbejë si një shtysë për kompanitë drejt zhvillimit të mëtejshëm të tyre fokusuar më së tepërmi në prodhimin me cikël të plotë, inkurajimin aktiv të sektorit në përmirësimin e kanaleve të komunikimit dhe marketingut.

Gjatë Edicionit të 2<sup>të</sup> të "Panairit të Tekstileve & Lëkurës 2019" do të lancohen trendet e fundit të veshjeve, këpuceve, cantave dhe aksesorëve për sezonin e ardhshëm duke përmirësuar kështu konkurrencën mbi modelet dhe dizajn-et e ndryshme dhe duke u fokusuar në teknikat më inovative të prodhimit të tyre.

Për më tepër, ky edicion do të shërbejë si vendi ideal për të promovuar projekte për rritjen profesionale të talenteve të reja dhe studentëve në shkollat e dizenjimit, modelingut, teknikët e mirëmbajtjes së makinerive etj.

## Industria e Tekstilit dhe Lëkurës në Shqipëri

Sektori i Tekstileve në Shqipëri është formësuar si rrjedhojë e një tradite të gjatë e marredhënieve me investitorë, ekspertë dhe blerës italianë në 20 vitet e fundit. Sektori i prodhimit të veshjeve siguron vende pune për më shumë se 35,000 punëtorë dhe pesha mesatare e sektorit në eksportet shqiptare është 15,2%. Tregjet kryesore janë Italia, Gjermania, Greqia dhe Spanja. Shqipëria përfaqëson një vendodhje strategjike me akses në tregjet e huaja, kosto të ulta dhe fuqi punëtore konkurruese. Në vitet e fundit një numër i rëndësishëm i prodhuesve janë zhvendosur drejt ciklit të plotë të prodhimit dhe shumë sipërmarrës kanë investuar në teknologji të reja, pajisje dhe njohuri që i kanë dhënë mundësinë atyre të shtojnë vlerë tek klientët dhe të zhvendosen në role të reja në procesin prodhues.

Industria e veshjeve dhe e këpucëve përfaqëson industrinë eksportuese kryesore në Shqipëri që ndër vite po i reziston konkurrencës me vendet e tjera. Duke iu referuar raportit rajonal të Bankes Botërore në vitin 2018, këpucët ishin produkti me peshën më të madhe në eksport. Më shumë se 100 kompani sëbashku prodhojnë mbi 1.2 milion palë këpucë në Shqipëri brenda muajit.

Shqipëria ka mbi 20,000 punëtorë këpucësh dhe lëkure dhe më shumë se 12,000 studentë që ndjekin kurse të formimit profesional në inxhinieri dhe sigurojnë një furnizim të vazhdueshëm të punonjësve të kualifikuar. "Panairi i Tekstileve & Lëkurës" mund të shërbejë si një "talent pool" për to.



## Ekspozuesit

Prodhues të lëndës së parë (industria e lehtë);  
 Prodhues veshjesh;  
 Prodhues të lëkurës;  
 Prodhues këpucësh;  
 Prodhues dhe tregtues të makinerive, pajisjeve dhe pjesëve të këmbimit për sektorin e tekstileve dhe lëkures;  
 Institucionet qeveritare dhe Agjensitë;  
 Institucionet arsimore;  
 Shoqatat e profesionistëve;  
 Sherbimet mbështetëse si printimi, paketimi, riciklimi etj  
 Të tjera: institucione financiare, kompanitë e sigurimit etj.

## Vizitorët

Specialistët/Ekspertët në fushën e tekstileve dhe lëkurës;  
 Tregëtuesit e pëlhurave;  
 Disenjues;  
 Konsulentë biznesi



## Avantazhet e ekspozimit në “Panairin e Tekstileve dhe Lëkurës 2019”

“Panairi i Tekstileve & Lëkurës 2019” do të risë ndërgjegjësimin për disavantazhet e sektorit të tekstileve dhe lëkurës në Shqipëri si: produktiviteti i ulët, teknologjia e pa-avancuar, numri i ulët i proceseve të performuara në vend dhe marketing-u i dobët. “Panairi i Tekstileve & Lëkures 2019” do të theksojë rëndësinë e zhvillimit të sektorit në Shqipëri dhe do të identifikojë sfidën e tij. Sfidat janë përmirësimi i produktivitetit dhe rritja e qëndrueshmërisë në sektorin e tekstileve dhe lëkures. Ky do të jetë një motivim i mirë për rritjen e investimeve në sektor; Bashkëpunimi dhe bashkëpunimi me sektorin privat në mënyrë që të rritet numri i kontratave me cikël të plotë prodhimi për produktet “Made in Albania”; Bashkëpunimi mes sektorit privat dhe atij publik; Prezantimi i teknologjive dhe makinerive inovatore të sektorit;  
 Talent Pool



# TEXTILE & Leather

Expo / 2019

November  
**01 - 02**  
2019



## Organizimi


Salla e panairit do të ndahet në 4 zona kryesore:

- I. Tekstilet dhe Veshjet
- II. Lëkura dhe Këpucët
- III. Teknologji, Makineri, Pajisje
- IV. Institucionet Arsimore/Talentet e reja

Kjo ndarje është bërë për ti kushtuar vëmendje objektivit kryesor të panairit, krijimit të pike takimi mes aktorëve më të rëndësishëm të sektorit, sfida e të cilëve është përqaftimi i inovacionit, kreativitetit, rritja e proceseve të përfunduara në Shqipëri dhe rritja e produktivitetit.

Expocity Albania është organizues i Panairove dhe Konferencave Kombëtare dhe Ndërkombëtare, i çertifikuar nga UFI, specializuar në organizimin dhe zhvillimin e panairove, ekspozitave dhe eventeve të ndryshme të biznesit, drejtuar tregut vendor dhe atij ndërkombëtar. Expocity Albania ju ofron pjesëmarrësve në këto aktivitete një strukturë dhe infrastrukturë të

plotë, bashkëkohore dhe të plotësuar me të gjitha lehtësitë dhe stafin e nevojshëm. Këto bashkë me 5'000 m<sup>2</sup> hapësirë të brendshme, 7'000 m<sup>2</sup> hapësirë të jashtme, e plotësojnë Expocity Albania si platformën më komplekse dhe më të përshtatshme për realizimin me sukses të këtij lloj komunikimi në Shqipëri



<https://expocity.al/en/mediterranean-tourism-fair/fotografi/#.XBtO-1xKhPY>

## EXPOCITY ALBANIA

Tirana-Durres Highway, Km 8, Tirana, Albania

Tel: +0688069393 | e-mail: [enejda.sheku@expocity.al](mailto:enejda.sheku@expocity.al) | web: [www.expocity.al](http://www.expocity.al)



visitor